



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 42
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204
Prishtinë, më 2 nëntor 2016, në orën 13:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka, Mirjetë Kalludra, Besa Baftiu dhe Ali Berisha.

Munguan: Adem Hoxha dhe Shukrije Bytyçi.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 19.10.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor, para miratimit në parim;
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19.10.2016

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 19.10.2016.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin Shëndetësor para miratimit në parim

Kryetarja: Projektligji është proceduar në Kuvend dhe tani do të vazhdojmë me procedurat e mëtejme, e hapi debatin për përkrahjen e Projektligjit në parim.

Pas miratimit në parim të Projektligjit nga Kuvendi mendoj se do ta formojmë grupin punues për amendamentim, dhe mendoj se grupi do të udhëhiqet nga deputetja Mirjeta Kalludra.

Besa Baftiu: Është një projektligj i një rëndësie të veçantë, pasi inspektoratet po kanë vështirësi në funksionim. Projektligji nuk dallon shumë nga Projektligji i më parshëm. Në memorandum thuhet se kanë bashkëpunuar me ekspertë dhe me shoqërinë civile, por sipas tabelave në memorandum shpjegues vetëm vërejtjet e zyrës së kryeministrit janë marrë parasysh, ndërsa vërejtjet e Odës së Farmacistëve nuk janë marrë parasysh. Pajtohem që duhet të kemi një debat publik me ekspertët sepse ashtu si është, Projektligji është i pa precizuar dhe shumë çështje janë lënë që të rregullohen me akte nënligjore. Vendet e rajonit kanë inspektorate të nivelit qendror dhe mendoj se edhe te ne ishte dashtë të rregullohen në atë mënyrë, që inspektoratet t'i përgjigjen drejtpërdrejt kryeministrit. Nga Ministria e Financave thuhet se Projektligji nuk ka implikime buxhetore shtesë, atëherë dihet se nuk do të shtohet numri i inspektorëve dhe, edhe ligji nuk do të ketë efekte pozitive. Si të tillë nuk e përkrah Projektligjin dhe abstenoj, nëse gjatë punës në grupe punuese e ndryshojmë, atëherë do ta përkrahi.

Fikrim Damka: Proceduarisht duhet të përkrahim Projektligjin dhe ta dërgojmë për lexim të parë në Kuvend, e pastaj pasi ta kalojë leximin e parë në Kuvend do të pajtohemi për mënyrën e punës.

Projektligji ka disa mangësi, sidomos financimi dhe struktura e brendshme e inspektoratit. Duhet të ceket se ku janë të përfshirë edhe inspektorati farmaceutik. Të shikojmë a mund ta ndryshojmë e ta bëjmë një ligj të mirë, e nëse nuk mundemi të kërkojmë nga ministri ta tërheq. Në parim e përkrah që të shkoj për lexim të parë në seancë.

Ali Berisha: Ky Projektligj ka shumë mangësi dhe mendoj që duhet të ketë komunikim me të gjithë ata që ndikohen nga ky ligj. Janë disa aspekte që nuk bën assesi të anashkalohen. E para është aspekti i funksioneve të inspektoratit, nuk janë vetëm funksione administrative, por edhe ekzekutive. Nuk mendoj që inspektoratet duhet të kalojnë te zyra e kryeministrit, pasi inspektorati shëndetësor është specifik për çështje shëndetësore, vendin e ka te Ministria e Shëndetësisë. Inspektorët pothuajse të gjithë janë punëtorë shëndetësorë dhe duhet të trajtohen si punëtorë shëndetësorë, sepse nuk janë shërbyes civil. Do të duhet të trajtohen edhe pagat e inspektorëve që nuk duhet të jenë si paga për shërbyes civil, por duhet të kenë si pagat e punëtorëve shëndetësorë sepse përndryshe nuk do të rrinë në inspektorat.

Flora Brovina: Nuk ka ardhur një Projektligj çfarë e kemi pritur, nuk besoj se do të sjellë një mbarëvajtje në funksionimin e Inspektoratit Shëndetësor. Inspektorët kanë deklaruar se nuk duan të jenë shërbyes civilë sepse e kanë titullin e punëtorit shëndetësor. Ta shohim a mund të bëjmë ndryshime dhe nivelin e inspektoratit shëndetësor ta ngrehim në nivelin e vendeve tjera të rajonit.

Çështjen e inspektorateve, si atij shëndetësor, ashtu edhe atij farmaceutik, duhet ta shqyrtojmë me vëmendje sepse ka shumë mangësi në funksionimin e tyre. Ka në treg shumë barna pa banderola dhe pa përshkrim në gjuhen shqipe, pastaj ka shumë papastërti në institucione shëndetësore, sidomos papastërti te nyjat sanitare. Projektligji ka ardhur i pa punuar mirë, prandaj duhet të punojmë shumë.

Hatim Baxhaku: Projektligji nuk i ka përmbushur pritjet tona dhe synimet që tentojnë të rregullohen me Projektligj. Por prapësepër mendoj se Projektligji duhet të kalojë në lexim të parë, e pastaj ka mjaft kohë që grupi punues të punojë që ta bëjë një ligj të mirë.

Fadil Beka: Pajtohem që Projektligji të kaloj në lexim të parë, e pastaj me amendamente duhet ta rregullojmë.

Fikrim Damka: Ka shumë çështje që mund të rregullohen si kjo se a janë inspektorët shëndetësorë shërbyes civilë a jo, por së pari të kaloj në lexim të parë, e pastaj do të punojmë bashkërisht.

Ali Berisha: Ligji për shërbyesit civilë e përcakton se cilat profesione nuk janë shërbyes civilë, pra është një diskrepancë mes ligjeve.

Kryetarja: Për të diskutuar këto çështje patjetër na duhet një debat më i gjerë publik.

Pas diskutimeve, Komisioni, me 5 vota për, 2 abstenime, përkrahu në parim, Projektligjin për Inspektoratin Shëndetësor.

4. Të ndryshme.

Kryetarja: Kemi dy kërkesa njëra nga mjekët specialist që kërkojnë të futen në buxhetin e vitit 2017 pagat e tyre, dhe shkresa tjetër nga Sindikata e Administratës së Kosovës lidhur me interpretimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Fikrim Damka: Nuk e dimë a janë përfshirë pagat e specialistëve në buxhetin e vitit 2017 a jo, nëse jo, atëherë ne do të bëjmë një rekomandim që këta duhet patjetër të përfshihen në buxhet. Nuk duhet të luhet me stafin shëndetësor, por duhet të ju gjendet një zgjidhje dhe të punësohen si punëtorë të rregullt.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që të kërkoj një informatë me shkrim nga Ministri i shëndetësisë se a janë përfshirë në buxhetin e vitit 2017 pagat e këtyre specialistëve.

Kryetarja: Sa i përket shkresës së sindikatës së administratës së Kosovës lidhur me interpretimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, këtë çështje do ta diskutojmë me ministrin e Punës, z. Arban Abrashi.

Hatim Baxhaku: Kur është miratuar ligji është diskutuar shumë dhe është e qartë se në atë grup është dashur të përfshihen të gjithë të larguarit me dhunë nga puna, por pasi nuk është specifikuar me ligj atëherë duhet të rregullohet me ligj ose me ndonjë akt nënligjor.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që ta ftojë në një mbledhje të Komisionit ministrin e Punës, z. Arban Abrashi dhe të diskutohet për zbatimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, por edhe çështja e marrëveshjes për pensionet me Zvicrën.

Kryetarja: Gjithashtu do të vazhdojmë me monitorimin e Ligjit të Shëndetësisë me vizita në institucionet shëndetësore private, dhe e përsëritim kërkesën për vizitë në spitalin e Mitrovicës së Veriut.

Mbledhja përfundoi në orën 15:05.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA